



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:039675

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352957

C.nr.666/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me bashkëpunëtoreshen profesionale B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditëses R.G. me numër personal nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,107.00 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, më datë 25.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Pa shqyrtim kryesor të çështjes

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses R.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, për shkak të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit.

II. DETYROHET e paditura, që paditëses, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, për periudhën kohore prej datës 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022 apo për 20 muaj (për çdo muaj shumën prej 55.35 euro, në shkallë prej 27% të pagës bazë- 421.00 euro, në emër të diferencës së papaguar të kualifikimit ose licencimit), t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,107.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, nga dita e parashtrimit të padisë më datë 02.02.2024 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit, t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja R.G. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 1,107.00 euro.

Të autorizuarit e paditësit në padi, kanë theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë SHFMU "Ardhmëria" në Prizren, ku vazhdon të punojë në këtë institucion. Tutje, ka

theksuar se për kualifikimin e paditësit me diplomë të fakultetit 3 apo 4 vjeçar, duhet të bëhet kompensimi shtesë prej 27% të vlerës së pagës bazë, e cila është 421 euro, apo shuma e gradimit 113.67 euro, ku aktualisht i paguhet vetëm shuma prej 58.32 euro, përkatësisht 55.35 euro në muaj më pak. Të njëjtit për 1 vit e 8 muaj pune nga data 01.05.2021, e deri me datë 31.12.2022, janë bërë 20 muaj, të cilat shumëzohen me shumën prej 55.35 euro del shuma e përgjithshme prej 1,107.00 euro. Andaj, ka propozuar që të aprovohet e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të detyrohet e paditura t'ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 1,107.00 euro, në emër të kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, me kamatë ligjore prej 8%. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditësit se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësi nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësi nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësja R.G. është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë pranë SHFMU “Ardhmëria” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditësit i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit përkatësisht diferencës konkrete të papaguar.

Gjykata përmes kontratës së punës nr. protokoli 28 e datës 01.09.2015, gjykata vërtetoi faktin se kualifikimi i paditëses është fakultet. Po ashtu, një fakt i tillë vërtetohet edhe nga diploma me numër 74, e datës 07.12.2010, lëshuar në emër të paditëses.

Në vazhdim, bazuar në listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet se lartësia e pagës bazë të paditësit është në shumë prej 421.00 euro dhe se paditësit në emër të kualifikimit fakultet, në pagën bazë mujore i është paguar shuma prej 58.32 euro.

Provat e lartcekura, gjykata i pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par. 1 të LPK-së, sipas së cilës dispozitë ligjore përcaktohet se “shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën

në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”. Andaj, meqë këto dokumente, përkatësisht kontrata e punës, licenca dhe lista e pagave janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, pasi që të njëjtat nuk janë kontestuar, gjykata ia fali besimin e plotë.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që “nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se “mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”. Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që “për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontrata e punës, rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ia ka paguar shumën prej 58.32 euro paditëses. Sipas pikës 4 nën pikës 2 të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008, paditësja përfiton ngritje prej 27% të pagës bazë, që në rastin konkret paditësja përfiton ngritje në pagën bazë, në emër të licencimit apo kualifikimit shumën prej 113.67 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën I. dhe II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën që paditësit për çdo muaj t’ia paguaj shumën prej 55.35 euro apo diferencën e mbetur, për 20 muaj nga data 01.05.2021 deri më datë 31.12.2022, në shumë të përgjithshme prej 1,107.00 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë më datë 02.02.2024, bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së, ku parashihet që “po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar

Numri i lëndës: 2024:039675
Datë: 25.10.2024
Numri i dokumentit: 06352957

dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritot.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, duke obliguar të paditurën që në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore, paditësit t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 134.00 euro, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, për përpilimin e padisë shumën prej 104.00 euro dhe për taksë gjyqësore shumën prej 30.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 152 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2024:039675, 25.10.2024

Gjyqtari,
Uran Zogaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.